



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 161/13**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić, dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosja (LVV) dega në Mitrovicë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Mitrovicë për shkak të vendosjes së posterave në vende publike për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 05.10.2013, mori këtë:

### **VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosja LVV, dega në Mitrovicë.

### **Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 04.10.2013 nga LVV, me të cilën pretendohet se me datën 03.10.2013 rreth orës 19:00 në Mitrovicë, në ndërtesën e Institutit Regjional të Shëndetësisë Publike në objektin ku gjendet edhe Qendra Rajonale e Administratës Pensionale, subjekti politik LDK ka vendosur poster të kandidatit të tyre për kryetar komune. Parashtruesi i ankesës pretendon se është bërë shkelje e nenit 33 pika b të LJP, nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013 dhe nenit 3 pika b të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur 4 (katër) fotografi si dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### **ankesa është e pabazuar**

Ankuesi në ankesën e tij pretendon se militantët e subjektit politik LDK kanë vendosur posterin në objektin e institucionit publik përkatësisht në Institutin Regjional të Shëndetësisë Publike, ku gjendet edhe Qendra Rajonale e Administratës Pensionale. PZAP-i, konstaton se pretendimet e tilla ankimore janë të pa bazuara pasi që nga fotografitë si dëshmi të cilat gjenden në shkresat e lëndës nuk identifikohen posterat e vendosur në murrin afër pllakatës së Institutit Regjional të Shëndetësisë Publike dhe Qendrës Rajonale të Administratës Publike, andaj një pretendim i tillë u vlerësua si i përgjithshëm dhe i pa argumentuar në prova dhe dëshmi bindëse, në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LJP-së, lidhur me ankesën e lartpërmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë**

Anr. 161/2013 më datën 05.10.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Nehat Idrizi**



***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*